

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Beqir Kalludra, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores Mybera Latifi, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit B.Xh.për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPK-së, dhe A.Xh.për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PP.nr.838/14 të dt.18.06.2015, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit të dytë gjyqësor me dt.05.10.2018, në të cilën kanë prezantuar prokurorja e shtetit Ferdane Sylejmani, i akuzuari B.Xh.me mbrojtësin e tij av.H.M. sipas autorizimit, dhe i akuzuari A.Xh.me mbrojtësin e tij av.R.K., sipas autorizimit, me dt.05.10.2018 mori, dhe në të njejtën ditë shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B.Xh., i biri i S. dhe Sh., e gjinisë K., i lindur me ..., në P., me vendbanim në rr. “T.Z.”, në P., i pamartuar, ka të kryer shkollën fillore, igjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, nuk ka të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

I akuzuari B.Xh., me datën 30.07.2014, rreth orës 21:00, në lagjen “E.”, në rr. “T.Z.”, në P., Njësiti rajonal i Stacionit policor “J.”, në P., me rastin e kontrollimit për një person të dyshuar për vepër penale, në Depon për shfrytëzimin e riciklimin e letrës, pronë e të pandehurit A.Xh. ,vëlla i të pandehurit B., kanë gjetur dhe sekuestruar tri paketime me substancë narkotike të llojit marijuanë, me peshë prej 2.950.57+0.0125 gram, të cilën e ka poseduar pa autorizim me qëllim që ta shesë dhe shpërndajë përfitime materiale.

-me këtë ka kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPK-së.

Prandaj gjykata konform dispozitave 2, 4, 41, 45, 46, 47, 73, 74, 75 par.1 pika 1.3, 76 dhe 273par.1dhe 5të KPRK-së, si dhe nenit 359, 365, 366, 368, 450, 453 të KPPRK-së, e:

GJYKON

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe

DËNIM ME GJOBË në shumën prej 1000 (njëmije)€, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar t'a paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin me gjobë, Gjykata ia zëvendëson dënimin me gjobë në dënim me burgim, duke ia llogaritur 1 (një) ditë burgim, me 20 Euro të gjobës, me kusht që afati i burgimit të mos i tejkalojë 6 muaj.

Detyrohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, ndërsa shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor, shumën prej 50 (pesëdhjetë) €, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 275 par.5 të KPRK-së, të akuzuarit i konfiskohen tri paketime me substancë narkotike të llojit marihanë, me peshë prej 2.950.57+0.0125 gram, si mjet me të cilën është kryer vepra penale.

Kundër të akuzuarit **A.Xh.**, i biri i S. dhe Sh., e gjinisë K., i lindur me ..., në P., tani me vendbanim në lagjen "K.", rr."T.Z." nr...., në P., zdrukthtar, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza konform nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPPRK-së,

REFUZOHAET AKUZA

Sepse:

me datë, kohë dhe vendin e përshkruar në dispozitivin e parë të aktakuzës, i pandehuri A.Xh.duke qenë pronar i deposë për shfrytëzimin e riciklimit të letrës, për periudhë të gjatë kohore prej rreth një viti ka mbajtë në posedim pa autorizim substancë narkotike të llojit marihanë, me peshë prej rreth 2.950.57+0.0125 gram, të cilën e kanë sekuestruar zyrtarët policor me rastin e kontrrollimit në depo.

-me këtë kishte për të kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropë ose analoge nga neni 275 par.1 të KPK-së.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, ka paraqitur aktakuzë PP.nr.838/14 të dt.18.06.2018,kundër të akuzuarit B.Xh.për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPK-së, dhe A.Xh.për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropë ose analoge nga neni 275 par.1 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimitfillestar me dt.27.08.2018 dhe pas leximit të aktakuzës, i akuzuari B.Xh.e ka pranuar në tërësi fajësinë për kryerjen e veprave penale për të cilën është akuzuar, derisa i akuzuari A.Xh.nuk e ka pranuar fajësinë për

veprën penale sipas aktakuzës.Kryetari i trupit gjykues e ka aprovuar deklaratën e të akuzuarit për pranimin e fajësisë pasi që janë plotësuar kushtet ligjore konform nenit 438 të KPPRK-së.

Ndërkaq në seancën e shqyrtimit të dytë, prokurorja e shtetit duke u përgjigjur gojarisht në kundërshtimet e mbrojtësit të të akuzuarit A.Xh.av.R.K.,është tërhequr nga akuza me arsyetimin se pas analizimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të kundërshtimeve të mbrojtjes e kërkesës për hudhjen e aktakuzës ka konstatuar se nuk ka elemente të mjaftueshme të cilat e përbëjnë figurën e kësaj vepre penale.

Meqë i akuzuari B.Xh.e ka pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi e kakuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për kryerjen e veprës penale, pranim i cili është bërë vullnetarisht, pranim i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnje shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPPRK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj vepre penale, dhe të njëjtën edhe e ka aprovuar, duke mos administruar asnje provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike.

Ashtu që, bazuar në një gjendje të tillë të pakontestuar të fakteve, gjykata vërtetojë se në veprimet e të akuzuarit Besart Xhaka, manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPK-së, ashtu që të akuzuarin edhe e shpalli fajtor, dhe i'a shqipto sanksionet penale përkatëse, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prokurorja e shtetitnë fund kadekluaruese i akuzuari B.Xh. ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, dhe këtë pranim e ka aprovuar gjykata, dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta gjykoj sipas ligjit, dhe me rastin e matjes sellojtit dhe lartësisë së dënimit i ka propozuar gjykatës që si rrëthanë lehtësuese të vlerësoj pranimin e fajësisë.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.Xh.av.H.M. i ka propozuar Kryetarit të trupit gjykues që me rastin e matjes sellojtit dhe lartësisë së dënimit ti vlerësojë rrëthanat lehtësuese të cilat janë në favor të të akuzuarit Besart, se i njëjti është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale, ka qenë i sinqertë, është në gjendje të rëndë ekonomiko-sociale, i paarsimuar mjaftueshëm por si punëtor ka qenë një punëtor i zellshëm, dhe që mbi 4 vite është në vuajtje të dënimit, duke shtuar se qëndrimi i të njëjtit në burg e ka arritur efektin e qëllimit të dënimit duke i propozuar gjykatës si rrëthanë veçanërisht lehtësuese edhe gjendjen e rëndë ekonomike të tij, meqenëse për këtë vepër penale janë të parapara dënimet kumulative edhe me burg edhe me gjobë, andaj bazuarnë këto rrëthana lut gjykatën që të njejtit t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë të mundshëm.

I akuzuari B.Xh.e ka mbështetë fjalën embrojtësit të tij lidhur me rrëthanat e propozuara gjykatës me rastin e matjes së dënimit duke shtuar se që 4 vite qëndron në Burgun e Dubravës, dhe nga qëndrimi i tij kaq gjatë në burgim,vlerëson se është arritur rehabilitimi i tij dhe i njëjti është penduar për këto vepreme dhe i ka premtuar gjykatës se vepreme të tilla të ngjashme nuk do ti përsëris në të ardhmen.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarin, i vlerësoi të gjitha rrëthanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 74 të KPRK-së, si rrëthanë lehtësuese për të akuzuarin, vlerësoi faktin se i njejtë ka pranuar fajësinë në mënyrë shumë të sinqertë që nga fillimi i kësaj procedure penale, sjelljen dhe qëndrimin e tij shumë korrekt në gjykatë, pendimin e thellë tëtijpër këtë veprer penale, premtimine të njejtë se në të ardhmen nuk do t'i përsërit asnjëherë këto veprime, gjendjen e rëndë ekonomike, ndërkaq si rrëthanë rënduese gjykata vlerësoi faktin se i njëjtë gjendet në vuajtje të dënimit për vepra tjera penale, andaj bazuar në këtë rrëthana të akuzuaritë shqiptoj sanksionin penal përkatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se një sanksion i tillë penal është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të këtyre veprave penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, dhe se dënim i shqiptuar do të ndikojë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarit dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 41 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarit, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlikuveshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarës, konform nenit 450 par.3 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me konfiskimin është marrë konform nenit 273par.5 të KPRK-së.

Ndërkaq sa i përket të akuzuarit A.Xh., meqenëse gjatë shqyrtimit të dytë prokurorja e çështjes është tërhequr ngaakuza, kryetari i trupit gjykues ka marrë aktgjykim refuzues konform nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 363 dhe 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.350/15, dt.05.10.2018

Procesmbajtësja
Mybera Latifi

Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari
Beqir Kalludra

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve
nga dita e marrjes së të njëjtët, e përmes kësaj gjykate.